

[Datë 22/12/2023]

Lënda: Njoftimi i shkurtuar i Kontratës i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike për procedurën e prokurimit me objekt: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing) për Policinë Bashkiake, Njësitë Administrative, MZSH dhe aparatën e Bashkisë Tiranë”, për publikim në buletinën e prokurimit publik.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT", TIRANË

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Bashkia e Tiranës
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tel/Faks: 00 355 4 22 56 799
E-mail: administrative.prokurime@tirana.al
Ueb-faqe www.tirana.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar- “Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues”.

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-92038-12-22-2023

Loti 1: REF-92041-12-22-2023

Loti 2: REF-92043-12-22-2023

Loti 3: REF-92045-12-22-2023

4. Objekti i kontratës/ Marrëveshjes Kuadër: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing) për Policinë Bashkiake, Njësitë Administrative, MZSH dhe aparatën e Bashkisë Tiranë”, i ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), autoveturë elektrike”

Loti 2: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Kamionçinë Pick UP”

Loti 3: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Mikrobus”

5. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 353.977.200 (treqind e pesëdhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekë pa TVSH, ose 3,412,157.3 (tre milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë pike tre) euro pa TVSH i ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), autoveturë elektrike”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: 252,325,080 (dyqind e pesëdhjetë e dy milion e treqind e njëzet e pesë mijë e tetëdhjetë) lekë pa tvsh, ose 2,432,281.4 (dy milion e katërqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e një pikë katër) euro pa TVSH;

Loti 2: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Kamionçinë Pick UP”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: 84,199,680 (tetëdhjetë e katër milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh, ose 811,641.5 (tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e një pike pesë) euro pa TVSH;

Loti 3: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Mikrobus”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: 17,452,440 (shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e dyzetë) lekë pa tvsh, ose 168,232.5 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e dy pike pesë) euro pa TVSH;

*** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 22/12/2023 është 103.74 Lekë/Euro.**

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga dita e dorëzimit të mjeteve në Bashkinë Tiranë, për secilin lot. Afati i levrimit të mjeteve 90 (nëntëdhjetë) ditë pune, termat e leasing 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj, për secilin lot.

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 25/01/2024; Ora:11:00